




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	26/10/2015
REFERENC-Ë:	AKK – DPK - DPKPP – 03-03/3525/15
PËR/ZA/TO:	z. Ibrahim HOXHA Menaxher i Prokurimit - Komuna Podujevë
CC:	z. Agim VELIU Kryetar – Komuna Podujevë
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Ndërtimi i urave në lagjen Duriqi, Jaha si dhe ndërtimi i murit mbrojtës në Metehi”

I nderuar z. HOXHA,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Ndërtimi i urave në lagjen Duriqi, Jaha si dhe ndërtimi i murit mbrojtës në Metehi” me numër prokurimi: 615/15/138/536, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin: “Ndërtimi i urave në lagjen Duriqi, Jaha si dhe ndërtimi i murit mbrojtës në Metehi” me numër prokurimi: 615/15/138/536, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Podujevës, bazuar në nevojën për ndërtimin e urave në lagjet Duriqi, Jaha dhe ndërtimin e murit mbrojtës në Metehi, ka paraparë aktivitet prokurimi me Procedurë të Kuotimit të Çmimit. Aktiviteti i prokurimit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik është shpallur më datë: 21/10/2015.

Agjencia kundër Korrupsion ka identifikuar se Komuna e Podujevës, si Autoritet Kontraktues gjatë përpilimit të dosjes së tenderit nuk ka dhënë vëmendjen e duhur, ku edhe janë bërë disa shkelje që bien ndesh me legjislacionin për Prokurim Publik.

Në Dosjen e Tenderit “Ndërtimi i urave në lagjen Duriqi, Jaha si dhe ndërtimi i murit mbrojtës në Metehi” bazuar në emërtimin e procedurës dhe në numrin e prokurimit, del të jetë zgjedhur “Procedura e Kuotimit të Çmimit” për të realizuar punët e parapara në këtë aktivitet prokurimi. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat për kuotimin e çmimeve për të ushtruar një aktivitet të prokurimit që ka për qëllim dhënien e një kontrate të punëve, furnizimeve ose shërbimeve me vlerë minimale ose të vogël. Në rast të kontratave për punë Procedura e Kuotimit të Çmimit mund të përfshijë vetëm riparime apo mirëmbajtje. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka të bëjë me pozicione të ndërtimit dhe një aktivitet i tillë nuk lejohet të zhvillohet me këtë procedurë. Nëse vlera e parashikuar është në limitin e Kuotimit të Çmimit, Autoriteti mund të përdor procedurë të hapur me vlerë të vogël.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 27 Dosja e Tenderit; dhe Nenin 36 Procedurat për kuotimin e çmimeve të Ligjit për Prokurimin Publik.

Agjencia Kundër Korrupsion i rekomandon Autoritetit Kontraktues që të marr hapat e nevojshëm për evitimin shkeljeve të lartë cekura dhe të veproj në pajtim me ligjin e Prokurimit gjatë vazhdimit të aktivitetit në fjalë.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !